



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") me datën 24.05.2018 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 02/2018

ORGANIZIMI I GARAVE NË KUADËR TË KAMPIONATIT KOMBËTAR

Për të rregulluar menyrën e organizimit, ndarjen e përgjegjësive dhe përkrahjen financiare të klubeve të cilët organizojnë gara në kuadër të kampionatit Kombëtar, bordi i FAK aprovoi këtë rregullore:

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Të gjitha garat që organizohen në kuadër të kampionatit kombëtarë obligohet të jenë gara ndërkombëtare FAI CLASS2. Pasi që çdo garë e këtij niveli është përgjegjësi e FAK dhe të drejtën për delegimin e plotë ose të pjesshëm, ose edhe për mosdelegim fare të organizimit të garës e mbanë vetëm bordi i FAK.
- 1.2 Kalendarit i garave për sezonin aktual garues, i cili përfshinë numrin e garave që organizohen për secilën dicitelinë si dhe datën e secilës garë shpallet nga bordi i FAK në muajin Janar të vitit.
- 1.3 Pas shpalljes së kalendarit garues për sezonin aktual, në afat prej 7 ditësh FAK i njofton të gjitha klubet të cilët janë anëtarë aktiv të sajë për këtë kalendar, si dhe shpall të hapur konkursin për organizim të garave në kuadër të kampionatit kombëtar. Bordi i FAK vendosë se për cilat nga garat e kalendarit të kampionatit kombëtarë do të shpall konkurs si dhe cilat gara dëshiroj ti organizoj drejtëpërdrejtë FAK.
- 1.4 Të gjitha klubet me status aktiv në FAK mund të aplikojnë në konkursin për organizim të garave në kuadër të kampionatit kombëtar. Klubet mund të aplikojnë si të vetme ose si bashkëpunim në mes të dy ose më së shumti tre klubeve për organizimin e garës.
- 1.5 Në rast se për ndonjërin nga garat në kalendar nuk ka interesim për organizim nga asnjë klub, atëherë FAK merr përsipër organizimin e garës në fjalë.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 2.

Shpallja e konkursit, aplikimi dhe afatet kohore

- 2.1 Konkursi për organizim të garave në kuadër të kampionatit kombëtar me të gjitha detajet për aplikim shpallet në webfaqen zyrtare të FAK, u dërgohet të gjitha klubeve aktive anëtarë të FAK në emailët e tyre si dhe kryetarët e secilit klub aktiv informohen për konkursin e hapur.
- 2.2 Konkursi për organizim të garave në kuadër të kampionatit kombëtar qëndron i hapur për 14 ditë nga data e shpalljes së sajë. Kjo datë duhet qartësisht të jetë e shënuar në konkurs dhe çdo aplikim pas kësaj date automatikisht refuzohet.
- 2.3 Konkursi i shpallur duhet të zhvillohet në dy faza:
- 2.3.1 **Faza 1:** Në afat prej 14 ditësh nga data e shpalljes së konkursit, klubet shprehin interesin e tyre për organizim të garës/ave përkatëse. Në këtë rast klubet duhet t'i dërgojnë të gjitha dokumentet e kërkuara që parasheh konkursi për organizim të garës.
- 2.3.2 **Faza 2:** Në afat prej 28 ditësh nga data e mbylljes së konkursit, klubet të cilët kanë shprehur interes për të organizuar ndonjë garë, bëjnë një prezantim në detaje të planit të tyre për organizim të garës, kushteve të tyre financiare, profesionale dhe logjistike për organizim. Në fund të prezantimit secili anëtarë i bordit të FAK mund t'iu drejtohet pyetje ose komente prezantuesëve.
- 2.3.3 Pas përfundimit të të gjitha prezantimeve nga klubet, bordi i FAK me shumicë të thjeshtë voton veç e veç për secilën garë për të cilën ka shpallur konkurs. Nëse për ndonjë garë kanë aplikuar më shumë se 2 klube, atëherë votimi organizohet në dy runde me sistem eliminimi, ku në raundin e dytë kalojnë 2 klube me më shumë vota nga të tjerët. Në rast barazimi të votave në raundin e parë në mes të vendit 2-të dhe 3-të, organizohet votim i veçantë për këto 2 klube dhe pastaj vazhdohet në raundin e dytë me 2 klube e para.
- 2.3.4 Stafi organizativ dhe profesional i garës përcaktohet menjëherë pas vendimit për delegim të një gare. Ky staf duhet gjithashtu të aprovohet nga kryesia e FAK me shumicë të thjeshtë.
- 2.4 Pas definimit të organizatorëve të garave të kampionatit kombëtar, FAK në afat kohor prej 7 ditësh nga data e vendimit të delegimit të organizimit të një gare, në webfaqe të saj prezanton listën e garave si dhe organizatorët e tyre. Gjithashtu në afat kohor prej 14 ditësh duhet të dërgojë aplikacionin në FAI për lajmërimin e këtyre garave.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 3.

Përkrahja financiare nga FAK për organizator-in/ët

- 3.1 FAK duke u bazuar në mundësitë e saja financiare zotohet ose jo për përkrahje të garave të cilët janë pjesë e kampionatit kombëtar dhe organizimin e të cilave ia ka deleguar një ose më shumë klubi/eve.
- 3.2 FAK obligohet të bëjë pagesën e kërkuar nga FAI për lajmërimin e garës dhe futjen e garës në kalendarin e garave ndërkombëtare.
- 3.3 FAK obligohet të bëjë pagesën e referëve të garës gjithashtu.
- 3.4 FAK obligohet të bëjë faqen elektronike të garës ku prezantohen të gjitha informatat për garën së bashku me mundësinë për regjistrim të garuesëve në këtë garë (kjo për përshtatje me kërkesat e FAI).
- 3.5 Obligimet tjera financiare për organizim të garës janë obligim i organizatorit/organizatorëve të garës.
- 3.6 Shuma e kuotizimit për pjesëmarrje në garë përcaktohet nga organizatori dhe i njëjti duhet të aprovohet nga FAK. Shuma e mbledhur nga kuotizimet i takon organizatorit të garës dhe të njëjtën duhet ta përdorë për organizim të garës.
- 3.7 50% e vlerës së kuotizimit ndahet për fondin e shpërblimeve të garës.
- 3.8 Në rast të gjendjes së mirë financiare FAK zotohet të përkrahë organizatorët e garave të kampionatit kombëtar dhe atë me këtë skemë:
 - FAK ofron të mbuloj shpenzimet e organizatorëve në shumën fikse prej 500 EUR,
 - FAK ofron të mbuloj shpenzimet e organizatorëve me një shumë shtesë variabile e cila shumë përcaktohet nga numri i pilotëve pjesëmarrës në garë, kjo shumë është 20 EUR e shumëzuar me numrin e pilotëve me licensë sportive të FAI që janë pjesëmarrës në garë, por që në asnjë mënyrë kjo shumë nuk mund të kaloj totalin prej 500 EUR.
- 3.9 Në rast të zotimit të FAK për përkrahje të garës dhe posedimit të mjeteve, FAK njofton organizatorët e garës për zotimin e mjeteve për garën në fjalë dhe atë 14 ditë para datës të fillimit të garës.



Federata Aeronautike e Kosovës

- 3.10 Organizatori i garës të gjitha kontratat dhe faturat tatimore me/nga palët e treta për të cilët kërkon mbulim financiar nga FAK duhet t'i ketë në emër të FAK (Emri i saktë dhe numri fiskal i FAK) dhe të njejtat në origjinal t'i dorëzoj në FAK për ekzekutim të pagesave nga ana e FAK. Të gjitha këto kontrata dhe fatura duhet t'i dorëzohen FAK-ut në afat prej 15 ditësh nga data e përfundimit të garës, në të kundërtën FAK nuk ka obligim të bëjë ekzekutimin e pagesave për faturat e dorëzuara më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të garës.
- 3.11 Në rast të mungesës së mjeteve ose të ndonjë jostabiliteti financiar të FAK, bordi i FAK mund të vendosë të shkuroj ose të anuloj plotësisht përkrahjen financiare për organizatorin e garës. Ky vendim duhet ti kumtohet organizatorit menjëherë pas nxjerrjes së sajë.

Neni 4. Hyrja në fuqi

- 4.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.
- 4.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 24.05.2018

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK